KOLONELI DAYRELL R. OAKLEY-HILL
(1898-1985)



Përgatitur nga Mal Berisha

KOLONELI DAYRELL R. OAKLEY-HILL

Ai ishte një nga oficerët britanikë të ngarkuar me organizimin e forcave policore shqiptare (xhandarmërisë) në vitet 1930, nën drejtimin e gjeneralit Sir Jocelyn Percy (1871–1952). Oakley-Hill lindi në Afrikën e Jugut, përfundoi formimin ushtarak në Sandhurst dhe shërbeu në ushtrinë indiane në Mesopotami, nga nëntori i vitit 1917 deri pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore.

Në vitin 1929, ai u angazhua në misionin britanik në Shqipëri dhe shërbeu kryesisht në Elbasan, ku mësoi gjuhën shqipe dhe udhëtoi gjerësisht nëpër vend. U detyrua të largohej nga Shqipëria në nëntor të vitit 1938, bashkë me të gjithë oficerët britanikë.

Gjatë viteve të para të Luftës së Dytë Botërore, ai punoi në Shërbimin e Operacioneve Speciale Ekzekutive (SOE) në Beograd dhe Kosovë, si specialist për çështjet shqiptare dhe për të ndihmuar në organizimin e rezistencës. Në vitin 1941, ai ra në duart e gjermanëve në Beograd dhe u mbajt si rob lufte deri në tetor 1943.

Në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, ai drejtoi misionin e Administratës së Kombeve të Bashkuara për Ndihmë dhe Rehabilitim (UNRRA) në Shqipëri, ku ofroi

ndihmë humanitare derisa puna u bë e pamundur. Për këtë arsye, ai dha dorëheqjen në vitin 1946.

Nga janari i vitit 1951 deri në vitin 1955, u emërua pranë Ambasadës Britanike në Athinë, ku punoi për shërbimet e fshehta britanike (MI6).

Në vitet e mëvonshme, ai shërbeu si kryetar i Shoqatës Anglo-Shqiptare në Londër. Kujtimet e tij janë botuar nga Qendra për Studime Shqiptare në vëllimin *"Një anglez në Shqipëri: Kujtimet e një oficeri britanik, 1929–1955"*, prej nga është marrë edhe ky fragment.

Kujtimet e kolonel Dayrell Oakley-Hill ofrojnë një përshkrim të gjallë të peizazhit, njerëzve dhe zakoneve të vendit tonë të bukur.

Ai i njohu mirë dy udhëheqës krejtësisht të ndryshëm: Mbretin Zog dhe Enver Hoxhën. Oakley-Hill u kthye në Britaninë e Madhe në vitin 1955, por nuk i ndërpreu kurrë lidhjet e tij me Shqipërinë. Deri në vdekjen e tij, në vitin 1985, ai ishte i palodhur në përpjekjet për të ndihmuar refugjatët shqiptarë dhe, për shumë vite, shërbeu si Sekretar i Shoqatës Anglo-Shqiptare.

Libri është botuar nga Qendra për Studime Shqiptare, e drejtuar nga studiuesi dhe historiani i njohur shqiptar nga Kosova, Bejtullah Destani.